



Planuar / Dorezuar Primijsena/Prodato Received/Delivery	27-01-2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMŠHCK	373/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1193/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Valentina Kaçandolli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1193/2021 të datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 26.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1193/2021 e datës 15.11.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 7045 i datës 13.12.2021 i Menaxherit të Sektorit të Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 15.12.2021, në formë elektronike ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6204/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokollit 7045 të datës 13.12.2021 të Menaxherit të Sektorit të Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, me pretendimin ankimor se është diskriminuar dhe eliminuar pa të drejtë nga konkurrimi në Konkursin e shpallur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për pozitën e punës Auditor i Brendshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me

datë 30.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa më datë 13.01.2022 KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen meritorë të çështjes ka administruar këto prova:
Ankesën e datës 15.12.2021 me numër A.nr.1193/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 6439 e datës 30.12.2021, Vendimi me numër protokolli 7045 i datës 13.12.2021 i Menaxherit të Sektorit të Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, E-mail nga J.M. për L.B. i datës 13.12.2021; E-mail nga J.M. për L.B. i datës 02.12.2021; E-mail nga L.B. për J.M. i datës 07.12.2021; E-mail nga J.M. për L.B. i datës 02.12.2021; Vendim me numër protokolli 6810 i datës 02.12.2021; E-mail nga J.M. për L.B. i datës 02.12.2021; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë i datës 27.10.2021; Lista e shkurtër me numër protokolli 6827 e datës 02.12.2021; Aplikacioni printscreen në SIMBNJ i L.B. fq 1/3, Referencë nr.01 Nr.09 e datës 05.02.2010 për ankuesen; Referencë e datës 08.02.2010 për ankuesen; Referencë me nr. protokolli 14/2010 e datës 08.02.2010 për ankuesen; Letër Rekomandim i datës 08.02.2010 për ankuesen; Referencë e datës 03.05.2006 për ankuesen; Vërtetim i datës 26.03.2001 i lëshuar nga Sekretari Gjimnazit "Jeta e Re" Suharekë për ankuesen; E-mail nga L.B. për J.M. i datës 07.12.2021; E-mail nga J.M. për L.B. i datës 02.12.2021; Ankesë e datës 07.12.2021 e ankueses kundër Vendimit nr. 07/4 nr.6810 i datës 02.12.2021; Diplomë me Nr. 2739 e datës 25.05.2011 për ankuesen; Diplomë me Nr.1522 e datës 20.04.2018 për ankuesen; Certifikatë nr. reference 271/2019 e datës 05.06.2019; Vërtetim i datës 15.11.2021 i lëshuar nga Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Akt Emërimi i datës 02.12.2013 për ankuesen ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 20.01.2021 për ankuesen ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.12.2019 për ankuesen; Certifikatë nr.05-01/25/21 e datës 10.02.2021 për ankuesen; Certifikatë e datës 27.01.2021 për ankuesen; Certifikatë e datës 08.09.2003 për ankuesen; Certifikatë e datës 08.06.2021 IKAP për ankuesen; Certifikatë e datës 02.06.2021 për ankuesen e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e datës 24.11.2005 për ankuesen; Certifikatë e datës 12.03.2012 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës tetor 2015 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga KDA e datës 15.11.2002 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKM e datës 26.09.2011 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKAP e datës 21.10.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKAP e datës 21.05.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKAP e datës 16.09.2016 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKAP e datës 19.02.2016 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IAKP e datës 08.10.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IKAP datës 24.09.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IAPK e datës 06.03.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga IAKP e datës 30.09.2014 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga College of Polising e datës 24.05.2013 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga EU shkurt 2015 për ankuesen; Certifikatë e lëshuar nga MDA dhe CORYS e datës 24.01.2013 për ankuesen; Certifikatë e datës 09.12.2011 për ankuesen; Certifikatë e datës 08.07.2011 për ankuesen; Certifikatë trajnimi 29-31 mars 2011 për ankuesen; Certifikatë trajnimi e datës 18.02.2011 për ankuesen; Certifikatë trajnimi e datës 02.02.2011 për ankuesen; Certifikatë trajnimi e datës 31.01.2012 për ankuesen; Certifikatë trajnimi te gjuhës angleze e datës 16.05.2012 për ankuesen; Certifikatë trajnimi e gjuhës angleze e datës 07.10.2011 për ankuesen; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 130/2022 e datës 13.01.2022; Aplikacioni i L.B. i datës 16.11.2021 me dokumentacionin e bashkangjitur, Aplikacioni i A.S. i datës 24.11.2021 me dokumentet e



bashkangjitura: Diplomë me Nr. 1078 e datës 24.01.2017; Diplomë me Nr. 3633 e datës 31.10.2013; Diplomë me Nr. 370/07 e datës 11.06.2007; Certifikatë e datës 12.03.2021; Certifikatë e datës 29.01.2017; Certifikatë e datës 12.10.2016; Certifikatë e datës 23.04.2015; Certifikatë e datës 26.01.2013; Certifikatë nga ShKÇAK për A.S. e vitit 2017; Certifikatë e datës 14.09.2012; Certifikatë e datës 30.07.2012; Certifikatë e datës 23.07.2012; Certifikatë e datës 08.05.2012; Certifikatë e datës 31.08.2010; Letër Rekomandim i datës 11.04.2012; Akt Emërimi i datës 03.04.2012; Letër Rekomandim i datës 06.07.2015; Vendim i datës 17.08.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.01.2020; Vërtetim punësimi i datës 18.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.01.2019; Letër falënderim e vitit 2019; Mirënjohje e vitit 2019; Vërtetim punësimi i datës 17.11.2021; Aplikacioni i L.B. i datës 25.11.2021; me shkresat e bashkangjitura: Diplomë me Nr. 044/15 i datës 13.01.2015; Diplomë me Nr. 271/08 i datës 15.11.2008; Certifikatë e datës 06.11.2019; Certifikatë e datës 25.04.2018; Certifikatë e datës 06.04.2018; Certifikatë e datës 21.03.2018; Licencë e datës 15.02.2018; Certifikatë e datës 01.08.2017; Certifikatë e vitit 2014; Certifikatë e datës 18.11.2014; Licencë e datës 18.12.2012; Certifikatë e datës 01.10.2015; Vendim mbi zgjedhjen e kandidatit i datës 24.02.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 15.12.2015; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 13.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.12.2019; Vërtetim i datës 25.11.2021; Akt Emërimi i datës 06.11.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 04.07.2013; Aplikacioni i V.P. i datës 11.11.2021 me shkresat e bashkangjitur: Diplomë me nr. 5059 i datës 26.03.2015; Diplomë me nr. 2041 i datës 01.11.2019; Certifikatë nga ShKÇAK për V.P. e vitit 2021; Certifikatë e datës 15.11.2019; Certifikatë e datës 16.10.2019; Certifikatë nga Demos e vitit 2020; Certifikatë nga ShKÇAK për V.P. e vitit 2015; Vërtetim i vitit 2020; Vërtetim i datës 06.10.2021; Rekomandim i vitit 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 05.02.2020; Vërtetim i datës 06.10.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka analizuar dhe shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës është konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 27.10.2021 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00007764 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Auditor i Brendshëm", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me datë 16.11.2021.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë në fazën e verifikimit paraprak, me Vendimin me numër protokoll 6810 të datës 02.12.2021, ka refuzuar aplikacionin e ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas konkursit në fjalë.

Ankuesja me datë 07.12.2021 ka ushtruar ankesë pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, kundër Vendimit me numër protokoll 6810 të datës 02.12.2021, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me Vendimin me numër protokoll 7045 të datës 13.12.2021, ka refuzuar ankesën e ankueses me arsyetimin se ankuesja nuk ka plotësuar kushtet dhe kërkesat për lëvizjen brenda kategorisë, të kërkuar sipas konkursit.



Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, kundër Vendimit me numër protokolli 6810 të datës 02.12.2021 të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë me pretendimin ankimor se është diskriminuar dhe eliminuar pa të drejtë nga konkurrimi në Konkursin e shpallur nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për pozitën e punës Auditor i Brendshëm.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenin 38 ku është përcaktuar se: 1 Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2 Nëpunësit civil të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës për lëvizje, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji..., si dhe dispozitat e Rregullores (QRK)Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 40 paragrafi 3 ku shprehimisht thuhet: Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil, dhe rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se plotësimi i pozitave të lira në Shërbimin Civil, në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, fillimisht bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, e cila procedurë e konkurrimi është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të Shërbimit Civil.

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, dhe duke u bazuar në konstatimin si me lart se Konkursi me numër reference RN00007764, për pozitën e punës Auditor i Brendshëm ka qenë konkurrim për lëvizje brenda kategorisë, Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të ankueses ka gjetur se e njëjta aktualisht ushtron detyrën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në kuadër të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar sipas Akt Emërimit të datës 02.12.2013, e cila pozitë bazuar në nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kategorizohet si pozitë e ulët drejtuese. Andaj, nisur nga fakti se pozita e punës Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa nuk është e së njëjtës kategori me pozitën e punës se Auditorit të Brendshëm si pozitë e kategorisë profesionale, Kolegji vlerëson se janë të pa bazuar pretendimet ankimore te ankueses se është diskriminuar nga konkurrimi për pozitën në fjalë.


Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1193/2021

Valentin Kaçandolli


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqesisë,
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqesisë
- Arkivit të KPMSHCK-së.